

Për Talhan [radiAll-llahu anhu] i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve selem] iu drejtua sahabëve dhe iu tha: „*Kush dëshiron të shikojë një xhennetli që shëtit mbi sipërfaqen e tokës le ta shikojë Talhan!*”

Nuk e di se mund të ketë në ditët e sotme ndonjë musliman të mirëfilltë dhe të mos ta shikojë me ëndje Talha ibn Ubejdullahun, atë që i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve selem] e përzgëzoi me Xhennet.

E lus All-llahun e Madhëruar që të na mëshirojë me mëshirën e Tij të madhe, të na i falë gabimet tona, të na e shtojë besimin, diturinë dhe të na bëjë prej atyre që e jetojnë dhe e përhapin fenë që All-llahu [subhanehu ve tealaa] e zgjodhi për ne, Islamin.

Amin!

Rezart Mezani

Redaktura gjuhësore: Klubi Studentor

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:

Shoqata Qytetare
Klubi Studentor

e-mail: penastudentore@hotmail.com



shikimi i njerzëve.

5. Si mashkulli, ashtu edhe femra që bën prostitucion *dënohet në Xhehennem*.

6. *Cilësohet me cilësitë më të këqia*, si shkatërrues, kurorëshkelës dhe tradhtar.

7. *Shkakton sëmundje vdekjeprurëse dhe të ngjashme*.

8. Humbja e *rastit të martesës me Hyritë* në vendbanimet e këndshme të Xhennetit.

Redaktura gjuhësore: Klubi Studentor

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:

Shoqata Qytetare
Klubi Studentor

e-mail: penastudentore@hotmail.com



Në historinë islame sahabët zënë një vend të rëndësishëm. Ata na sjellin edhe jetën e tyre të thjeshtë e modeste dhe njëkohësisht, çka është më e rëndësishmja, edhe bindjen ndaj All-llahut [subhanehu ve tealaa] dhe të Dërguarit të Tij. Ata ishin shembulli i praktikimit të urdhërave të All-llahut [subhanehu ve tealaa] dhe të Dërguarit të Tij [sal-lall-llahu alejhi ve selem], prandaj i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve selem] ata i krahason me yjet që shndërritin në qiell. Me ndihmën e tyre feja islame u transmetua deri në ditët tona.

Gjëja që më shumë gjëjmë ose vërejmë tek ata është qëndrueshmëria i tyre në rrugën e All-llahut [subhanehu ve tealaa], dashuria ndaj All-llahut [subhanehu ve tealaa] dhe të Dërguarit të tij [sal-lall-llahu alejhi ve selem]. Kur në luftë ata plagoseshin dhe i pyesnin: „Si je?“, ata thonin: „Si është i Dërguari i All-llahut?“

Këtë e gjejmë edhe tek gratë e sahabëve. Kur po ktheheshin nga një luftë i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve selem] bashkë me sahabët, një prej grave që kishin dalë për t'i prituri u thanë: „Burri tu vra“.

Ajo tha (pyeti): „Si është i Dërguari i All-llahut?“

Ata i thanë prap: „Tu vra djali“.

Ajo prap pyeti: „Më thoni si është i Dërguari!“ dhe kur ata i thanë se i Dërguari i All-llahut është mirë, atëherë ajo u qetësua.

Në Luftën e Uhudit muslimanët, ngaqë e thyen urdhërin e të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve selem], pësuan disfatë. Në këtë luftë gjejmë edhe vetmohimin e disa sahabëve, ku me trupat e tyre mbrojtën të Dërguarin e All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve selem]. Trupat e tyre ishin një mburojë ndaj shpatave dhe shtizave të kafirve (pabesimtarëve). Një nga këta ishte edhe Talha ibn U b e j d u l l a h [r a d i A l l - l l a h u a n h u]. Talha në këtë luftë morri shtatëdhjetë (në një rivajet tjetër thuhet se ka marrë shtatëdhjetë e pesë) plagë në trup, e humbi edhe një gisht të dorës. Mëgjithatë kur u përmend dhe Ebu Bekri e pyeti: „Si je?“, ai,

mëgjithëse kishte marrë gjithë këto plagë dhe kishte dhimbje, tha: „A është gjallë i Dërguari i All-llahut?“

Ata e vleresonin njeri-tjetrin nga imani, nga veprat që bënin. Andaj Ebu Bekri [radiAll-llahu anhu] thotë se Lufta e Uhudit ishte dita e Talhas. Ata e shikonin me ëndje vëllain e tyre që fitonte mëshirën e All-llahut [subhanehu ve tealaa], që fitonte Xhennetin.

Kur po ktheheshin nga Lufta e Uhudit, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve selem] i thotë Hassanit (poetit të tij): „*Thuaj ndonjë gjë rreth Talhas*“. Dhe ai recitoi këtë poezi:

„*Talha e ndihmoi Muhammedin në ditën e Betejës së Uhudit dhe kjo ndihmë ishte në kohën më të vështirë të të Dërguarit.*

Për ta mbrojtur atë duart i bëri mburojë kundër shtizave nga gjuajtjet e shpatave iu prenë damarët e gjishtit, u mbulua me gjak, mbeti i gjymtë.

Përveç Muhammedit ai ishte i pari.

E mbajti në këmbë gurin e mullirit Islam dhe Islami përqafoi të ardhmen“.

Ndërsa Ebu Bekri [radiAll-llahu anhu] për Talhan recitoi këtë poezi:

„*Kur armiqtë po e ndiqnin të Dërguarin e All-llahut, (Talha) e mbrojtë të Dërguarin e rrugës së drejtë.*

Kur muslimanët po iknin, atëherë kur u përplasen me ata, ai mbrojtë fenë me gjithë plagët e rënda (që kishte marrë).

O Talha ibn Ubejdullah, tu bë borxh Xhenneti. Martohu me hyritë sy sorkadhe“.

Kurse Omeri [radiAll-llahu anhu] e tha shumë bukur këtë pjesë:

Kur të gjithë muslimanët e lanë fushën e luftës po shpërndaheshin,

Talha mbrojtë të Dërguarin e rrugës së drejtë.

Me të thënë kështu Omeri, Resulull-llahu [sal-lall-llahu alejhi ve selem] tha: „*Të drejtën the, o Omer“.*

Vëlla dhe motër e nderuar!

Ka gabuar ai i cili mendon se rruga e qëndrimit [rruga e paqes, rruga që të shpie në moral të lartë, rruga për të cilën All-llahu [subhanehu ve tealaa] i ka lavdëruar ata që e pasojnë atë, rruga e shpëtimit, rruga drejt Xhennetit, që të bën të lumtur në të dy jetët] është ajo e cila i ndalon të gjitha kënaqësitë në këtë botë, të ndalon nga shakaja dhe nga epsheet krejtësisht.

Nuk është ashtu!

Islami këtyre çështjeve u ka vënë rregulla dhe kufinj të caktuar, në mënyrë që njeriu mos të bëhet viktimë e epshit dhe e punëve të kota. Mirëpo, për të mos iu lënë vend fjalëve të atyre që thonë se Islami ka lënë mangut shumë gjëra, ne themi:

- **Kurorëzimi:** Islami i ka dhënë rëndësi të veçantë kurorëzimit dhe e ka bërë rrugë për mbrojtjen e epshit, rrugë të dashurisë dhe mëshirës mes dy bashkëshortëve. Thotë All-llahu në Kur'an: „***Dhe nga faktet*** (e madhë risë) ***së Tij është që për të mirën tuaj Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën*** (gratë), ***ashtu që të gjeni prehje tek to dhe mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këto ka argumente për njerëzit që mendojnë“*** [Err-Rrum: 21].

- Duke shikuar forcën e thirrjes së epsheve tek rinia, Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve selem] ka veçuar një çështje të tillë, ku thotë: „*O ju të rinj, kush pre jush ka mundësi, le të martohet, se ajo (martesa) e ndalon nga shikimet dhe e mbron organin (gjenital); dhe kush nuk ka mundësi, le të agjërojë, sepse agjërimi është mbrojtje për të...!*“ (Mutefekun alejhi).

Dhe në kurorëzim kemi dobi të çmueshme, prej tyre:

1. Me anë të saj *respektohet urdhëri i All-llahut* [subhanehu ve tealaa] dhe bëhet ndjekja e pejgamberëve.

2. Arrihet *kënaqësia, mëshira dhe bashkëpunimi mes dy*

bashkëshortëve.

3. *Mbrohet fisi dhe nuk bëhet përzierje dhe shkatërrim.*

4. Me të e mbron organin tënd [gjenital] dhe largohesh nga *gjërat që Islami i ka ndaluar.*

5. Me të arrihet *shtimi i natalitetit* [lindshmërisë] dhe forcimi i rrjetit islam, duke ia shtuar me këtë frikën armikut.

6. Arrihet *mbrojtja e shoqërisë* [islame] nga përçarja dhe shkatërrimi.

7. Mbrohen bashkëshortët nga *sëmundjet e ndryshme* [vdekje prurëse], të cilat vijnë për shkak të shfrenimit të epsheve në mënyrë të cilën e ka ndaluar All-llahu Fuqiptotë.

Vëlla dhe motër e nderuar!

Islami e ka ndaluar prostitucionin, për shkak të këqiave trupore që ndodhin në individë, familje dhe shoqëri. Se me prostitucion arrihet përzierje [zbritje e moralit] në fise, bëhet përhapja e urrejtjes dhe mosdashjes, varfërisë dhe problemeve. Se prostitucioni mbledh rreth veti gjithë të këqiat dhe atë që është më parësore - lënien e fesë, heqjen dorë nga sinqeriteti, përhapjen e papunësisë, pakësimin e xhelozisë, saqë nuk gjen person i cili bën prostitucion e të ketë sinqeritet të lartë, as kryerje të premtimeve, as vërtetësi në bisedë, as kujdesje ndaj shoqërisë, e as xhelozie për familjen e tij.

Disa nga dëmet e prostitucionit:

1. *Urrejtja e All-llahut* ndaj kryerjes së kësaj vepre të ndaluar.

2. *Nxirje të fytyrës, dëmtim të zemrës dhe ngushtim në gjoks.*

3. *Varfëri të pashmangshme* për shkak të prostitucionit, edhe nëse për këtë duhet të kalojë një kohë e caktuar.

4. *Largimi nga shikimi i All-llahut* [subhanehu ve tealaa] dhe nga